



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISE - OPSTINA VITINA

20-04-2026			
02-055/07-450			



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale NR.03/L-040 (Gazeta Zyrtare NR 28/2008), neni 8 i Rregullores së Ministrisë së Financave nr.04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, neni 51.1 të Statutit të Komunës së Vitisë nr 01-013/491 të datës 23.12.2016, dhe sipas Thirrjes Publike për mbështetje financiare të entiteteve publike me numër protokollit 02-118-02-336 e datës 16.03.2026, Kryetari i Komunës së Vitisë, me datë 20.04.2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR NDARJEN E SUBVENCIONEVE TË DREJTORISË PËR KULTURË, RINI DHE SPORT PËR VITIN 2026

I. Në bazë të Thirrjes Publike për mbështetjen financiare të entiteteve publike, me numër protokollit 02-118-02-336 e datës 16.03.2026, me këtë Vendim, kryetari i Komunës së Vitisë, formon komision për ndarjen e Subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport me mandat 1 (një) vjeçar.

Komisioni përbëhet prej 5 Anëtarë të rregullt dhe 1 anëtar rezervë dhe ka këtë përbërje:

1. Ismet Sejdiu - Kryetar i komisionit,
2. Besa Mustafa - Anëtare e komisionit,
3. Ganimete Emini - Anëtare e komisionit,
4. Fehmi Rexhepi - Anëtar i komisionit,
5. Besim Aliu - Anëtar i komisionit,
6. Antoneta Palja - Antare rezervë,

II. Komisioni nga pika I i këtij Vendimi, ka për detyrë që të vlerësoj aplikacionet e projektpropozimet në pajtim me rregulloren e Ministrisë së Financave nr.04/2017 dhe thirrjes Publike për Subvencionimin e OJQ-ve, si dhe të ndaj buxhetin e paraparë për Subvencione.

III. Për implementimin e këtij vendimi do përkujdeset kryetari i komisionit ndërsa për zbatim Kryetari i Komunes së Vitisë.

IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Anëtarëve të Komisionit,
2. Zyrës së Kryetarit,
3. Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport
4. Zyres Ligjore,
5. Arkivit,

KRYETARI I KOMUNËS SË VITISË
Sokol Haliti

